



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 37 prot.

Kamëz, më 11.3.2022

V E N D I M

Nr. 33 Datë 11 / 3 2022

MBI

MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI DHE NJË SHTESE NË LISTËN E SUBJEKTEVE TË VENDIMEVE NR. 147 DATË 07.12.2020 DHE NR.22 DATË 19.02.2021, TË CILËT PËRFITOJNË NGA GRANTET PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, VLERËSUAR NGA AKT-EKSPERTIZAT E THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT ME NIVEL DËMTIMI “ PËR SHEMBJE “

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 11.03.2022 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendim Nr.30 Datë 10.03.2022** në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, aktin nr. 09 datë 16.12.2019, “ Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore ” dhe aktet nën-ligjore për zbatim të tij, Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “ Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 “ Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit ”, Vendim Nr.5, datë 06.01.2020 i ndryshuar “ Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model ”, Vendim Nr.8, datë 06.01.2020 “ Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, Vendim Nr. 887, datë 24.12.2019 “ Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Vendim Nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit ” për shkak të tërmetit të 26.11.2019; Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr.97, datë 19.02.2021 “ Për një ndryshim të Urdhërit nr.108, datë 24.02.2020 për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të Posaçëm të Rindërtimit”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

V E N D O S I:

1. Miratimin e një ndryshimi ne listën e subjekteve për fitues të Vendimeve të Këshillit Bashkiak nr.147 ,datë 17.12.2020,dhe nr.22, datë 19.02.2021.
2. Miratimin e një shtese të subjekteve përfitues, pasi është përcaktuar nga oponenta teknike e Institutit të Ndërtimit që objekti kalon 70% të kostos së rindërtimit nga e para.
3. Lista e subjekteve që shfuqizohen në pikën 1 (një) të këtij vendimi, paraqitet në aneksin bashkë-lidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
4. Lista e subjekteve shtesë të përcaktuar në pikën 2 (dy) të këtij vendimi, paraqitet në aneksin bashkë-lidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
Hysen Koldashi

